



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 17
Prishtinë, më 13 korrik 2010, në orën 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Gani Koci, Anita Morina-Saraçi, Riza Smaka, Synavere Rysha dhe Enis Kervan.

Mungoi: Naser Osmani

Të ftuar: Lage Olofsson – ZAP (mungoi), MEF – Lulzim Ismajli dhe Kosum Aliu, MASHT-Skender Xhakaliu, MKRS - Salih Morina, ASHAK- Zija Bylykbashi dhe Vjollca Hykolli.

Të pranishëm: Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri - zyrtare ligjore, Musa Rudaku – zyrtar për ekonomi dhe financa, KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Shpresa Miftari – praktikante, nga Zyra e Presidentit – Nexhat Shatri dhe nga KDI - Jusuf Zejna.

Mbledhjen e kryesoi Haki Shatri - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës,**
2. **Miratimi i procesverbalit të dëgjimit publik të 30. 06. 2010,**
3. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009,**
4. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performancës “Efektiviteti i procesit të certifikimit të pagesave”,**
5. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të dëgjimit publik të 30. 06. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi procesverbalin e dëgjimi publik të 30. 06. 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009

Kryesuesi – I ftoi përfaqësuesit e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ta paraqitnin Raportin.

Zija Bylkbashi - ASHAK - Lidhur me të gjeturat e auditorit, e përmendi mungesën e stafit profesional. Ka mosrespektim të rregullave financiare, lëshime profesionale që kryesisht janë të përqendruara në çështjet e prokurimit. Në mungesë të stafit, Akademia është munduar që aty ku nuk ka konflikt interesi - për kryerjen e disa punëve - të angazhohet i njëjti person. Buxheti i Akademisë është rreth 460.000 euro. Me të drejtë auditori ka konstatuar se një person që i ka plotësuar kushtet për pension - i moshës mbi 65 vjet - është në marrëdhënie pune. Akademia lidhur me këtë në qershor ka bërë një shkresë në Ministrinë e Administratës Publike, me arsyetimin se sekretari i ASHAK-ut, duhet ta vazhdojë punën në mënyrë që të shfrytëzohet përvoja e tij në riorganizimin e Akademisë. Ministria e Administratës Publike nuk i është përgjigjur kësaj shkrese. Pas konstatimit të auditorit, lidhur me këtë çështje, Akademia ka shpallur konkurs. Asnjë kandidatë nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit. Afati është zgjatuar dhe mbaron më 29 korrik 2010. Deri në fund të gushtit do të përfundojnë këto procedura. Prandaj është vendosur që sekretarit aktual t'i ndërpritet marrëdhënia e punës më 31 gusht 2010.

Sa i përket sistemit të kontrollit të brendshëm, Akademia ka mungesë stafi. Ka pranua një zyrtar certifikues, i cili do ta fillojë punën nga muaji shtator.

Do të bëhen planifikime të qëndrueshme të shpenzimeve. Ka shkelje, por kjo është mungesë e aftësisë profesionale. Në përgjithësi konstatimet e auditorit qëndrojnë dhe nga ASHAK-ja do të përmbushen të gjitha këto rekomandime. ASHAK-ja, me forcat që i ka, do ta angazhojë një auditor të brendshëm.

Kryesuesi - Raporti i ZAP-it lidhur me ASHAK-në nuk paraqet shkelje të rënda. Si organizatë, ASHAK-ja është e detyruar t'i përgjigjet auditorit për masat e ndërmarra. Sa i përket auditorit të brendshëm, ASHAK-ja mund ta bëjë në bashkëpunim me organizatat e tjera të vogla buxhetore.

Gani Koci - Organizatat e vogla buxhetore edhe pse kanë buxhet të vogël, megjithatë ai buxhet duhet të zbatohet sipas rregullave të caktuara. Ligji i auditimit të brendshëm lejon që organizatat e vogla buxhetore të kenë një auditor të përbashkët. E njëjta gjë qëndron edhe me prokurimin, ku sipas LPP-së aty ku organizatat nuk kanë kapacitete të prokurimit, lejohet një organizatë tjetër që ta bëjë prokurimin në emër të asaj organizate ose të APP-së.

Safete Hadergjonaj – ASHAK-ja për disa pozita kyçe ka pasur mundësi punësimi, sepse me buxhet i është lejuar punësimi i 47 punëtorëve, ndërsa të punësuar janë vetëm 25. Mungesa e një raporti për hapjen dhe për vlerësimin e ofertave krijon dyshime për keqpërdorime. Për të gjitha prokurimet, sado që vlera mund të jetë e vogël, kur dyshohet se ka keqpërdorime, për institucionin krijohet një opinion negativ. Nëse punëtori nuk mund ta kryejë punën si pasojë e aftësisë profesionale, duhet të sistemohet në një vend tjetër të punës. Auditimin e brendshëm mund ta bëjë auditori i MEF-it, ndërsa çështja e sekretarit të Akademisë duhet të zgjidhet.

Riza Smaka – ASHAK-ja është institucion shumë i rëndësishëm. Raporti i ZAP-it përmban rekomandime që mund të zbatohen. Pasqyrat financiare paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të ASHAK-së, për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2009. Ka pikëpamje të shkëlqyeshme për këtë raport.

Synavere Rysha - Raporti ka përfunduar me gjashtë rekomandime. Raporti e ka paraqitur gjendjen reale në këtë institucion. Kjo duket edhe nga faktet, të cilat edhe sekretari i këtij institucioni, po i deklaroi. Më shqetësues është rekomandimi i tretë - për zyrtarin financiar, i cili merret me financat, me kontabilitetin dhe me paranë e imtë. Këtij personi duhet t'i ndahen detyrat, sepse në Akademi i njëjti person merret me shumë çështje. Duhet të shikohet mundësia

që këto lëshime të mos përsëriten. Rekomandimet duhet të zbatohen të gjitha. Raportin e vlerësojmë të mirë dhe real, ndërsa puna e ASHAK-së është për t'u përshëndetur.

Anita Morina – E sugjeroj ASHAK-në për përzgjedhjen e funksionit të auditorit të brendshëm, sepse kjo sigurisht do të ndikojë për një funksion më të mirë. Sa i përket Raportit ajo tha se është bërë rutinë që të gjitha raportet e auditura të kenë konstatimin se *“ka probleme me procedurat e prokurimit, të cilat nuk janë në pajtim me procedurat e prokurimit të LPP-së”*, por kjo do të diskutohet me përfaqësuesit e Ministrisë.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

KMFP-ja e përkrah Raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të auditimit të pasqyrave financiare të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.

Detyrohet Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, që lidhur me Raportin, të cilin do ta përgatisin për ZAP-in për veprimet e ndërmarra, ta njoftojë edhe KMFP-në.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performancës “Efektiviteti i procesit të certifikimit të pagesave”

Lulzim Ismajli - drejtor i Thesarit MEF – Raporti i auditimit ka të bëjë me pozitën e punës së zyrtarit certifikues, në ministritë që janë përfshirë në këtë Raport. Realisht është audituar komplet procesi i punës së auditorit. Zyrtari certifikues e ka pozitën e përshkruar në kuadër të rregullës financiare numër 1 të Departamentit të Thesarit. Realisht pozita e zyrtarit certifikues përfshihet me Ligjin për menaxhimin e financave publike, si pozitë e mbrojtur dhe si pozitë, e cila duhet të jetë e pavarur nga ndikimet eventuale. Zyrtari certifikues e ka për detyrë të konstatojë se mjetet janë ndarë në pajtim me Ligjin për ndarjet buxhetore; e ka për detyrë të konstatojë se është në ekzekutim para nënshkrimit të kontratës dhe e ka për detyrë të konstatojë se mallrat janë pranuar në përputhje me kontratën. Pra, e ka për detyrë t'i konstatojë edhe çështjet formale të prokurimit, si dhe ta bëjë verifikimin, nëse zyrtarët i kanë dhënë nënshkrimet e duhura. Në fund të nënshkruajë vetë organizata buxhetore - ministria përkatëse. Me këtë nënshkrim nga zyrtari certifikues, pagesa është përfundimtare dhe procedohet tutje. Sa i përket çështjes së kodeve, ministritë, nëse kanë bërë ndonjë lëshim të evidencimit të kodit ekonomik, mund ta korrigjojnë gjatë vitit, këto korrigjime kontabile (periudha tremujore, siç është e përcaktuar me ligj). Korrigjimet mund t'i bëjnë edhe në fund të vitit, në kuadër të raportimeve përfundimtare financiare. MEF-i ka filluar me adresimin e rekomandimeve të auditorit. Është një projekt i mbështetur nga Komisioni Evropian, i cili ka filluar me shqyrtimin e dokumenteve të politikave për kontrollin e brendshëm të financave publike. Në kuadër të kësaj është duke e adresuar edhe punimin e një plani të veprimit.

Riza Smaka - Auditimi ka gjetur dobësi në të gjitha aspektet e procesit të certifikimit. Sipas raportit ka gjetje të shumta, si: nuk ka dëshmi se kushtet e kontratës janë përmbushur para se të bëhet pagesa. Raportet nuk janë bërë me shkrim. Kërkesave ligjore të LPP-së nuk u është kushtuar vëmendje. Faturat janë paguar pas datës së pagesës dhe për to nuk është raportuar fare. Shpenzimet janë klasifikuar në kode të gabuara. Mjetet janë zotuar pas nënshkrimit të kontratës. Kërkoj përgjigje për këto çështje.

Safete Hadergjona - Puna e zyrtarit certifikues është një pozicion shumë i rëndësishëm brenda institucionit. Gjëja më pozitive e raportit të auditimit është pikërisht ngritja e kësaj çështjeje si problem, që zyrtarët certifikues ta luajnë rolin e vet brenda institucionit. Sipas Raportit nuk janë mbajtur trajnime sa duhet me këta zyrtarë certifikues. Pse nuk janë mbajtur këto trajnime? Ky është fokusi kryesor i të gjitha të gjeturave të auditorit.

Anita Morina – Të gjeturave se “*kërkesave të LPP-së nuk u kushtohet vëmendje*”, janë konstatime thuajse në të gjitha raportet e auditorit. Janë disa të gjetura të tjera si: mjetet janë zotuar pas nënshkrimit të kontratës, pagesat e parregullta nuk janë raportuar me shkrim. Është shqetësues fakti i mostrajtimin të këtyre zyrtarëve. Sipas përfaqësuesit të Departamentit të Thesarit, përshkrimi i detyrave të punës së zyrtarit certifikues është i paraparë me ligj. Sipas Raportit të auditorit thuhet se zyrtarët certifikues nuk kanë përshkrim të detyrave të punës si pasojë e mungesës së rregulloreve të brendshme. Ministria duhet t’u krijojë kushte më të mira, të ndajë buxhet për trajnime për këtë zyrtarë.

Kërkoj sqarime për pagesat e parregullta, që nuk janë raportuar me shkrim. A ka filluar të bëhet ndonjë rregullore e punës apo ndonjë specifikim i punës, sepse sipas Raportit ka të gjetura që dëshmojnë se nuk ka kritere të qarta, dhe prioritetet sipas të cilave zyrtarët do ta bënin certifikimin e pagesave?

Sinavere Rysha - 45% të mostrave të transaksioneve të rishikuara kanë mangësi. Kjo është shqetësuese. Janë gjashtë rekomandime, të cilat, edhe pse janë marrë në katër ministri, nuk do të thotë se e njëjta situatë nuk është edhe në ministrinë e tjera. Nëse nuk janë përmbushur kushtet e kontratës, del se është shkelje serioze. Raportet nuk janë bërë me shkrim. Zyrtari certifikues është personi i fundit që e bën pagesën. Në këtë proces nuk përfshihet vetëm zyrtari certifikues, sepse janë edhe shumë zyrtarë të tjerë, derisa të vijë deri të zyrtari certifikues. Ka pasur shumë shkelje nga zyrtarët e tjerë, të cilat është dashur t’i evitonte zyrtari certifikues. Kjo nuk ka ndodhur.

Kërkesave ligjore nuk u është kushtuar vëmendje këtu hyjnë kontratat e parregullta, faturat që janë paguar pas datës së pagesës dhe nuk janë raportuar fare nga zyrtari certifikues. Kjo duhet të eliminohet. Shpenzimet janë klasifikuar në kode të gabuara. Kjo nuk ka ndodhur rastësisht dhe nuk është për t’u vlerësuar pozitivisht. Mjetet janë zotuar pas nënshkrimit të kontratës. Sipas ligjit, mjetet duhet të zotohen para nënshkrimit të kontratës. Të gjeturat e ZAP-it nuk janë për t’u injoruar, por për t’u vlerësuar dhe për t’u eliminuar.

Gani Koci - Në parim e vlerësoj Raportin e ZAP-it. Nuk e kuptoj fjalinë “*Faturat janë paguar pas datës së pagesës*”. A është fjala pas datës së parashikuar në kontratë apo si? Sa u përket rekomandimeve, nuk do të duhej t’u shtohet asgjë, përveç që ministrinë përkatëse, përkatësisht MEF-i, të fillojnë t’i zbatojnë ato me përpikëri.

Sa i përket gjetjes: “*zyrtarët certifikues nuk kanë përshkrim të vendit të punës*”, ekziston një institucion i konkursit. Nëse askund nuk ka përshkrim të vendit të punës, përshkrimi i vendit të punës bëhet në konkurs. ZAP-i duhet të jetë i kujdesshëm në vlerësimet e tij. Vlerësimi i auditorit do të duhej të mbështetej, në atë se a e ka kryer zyrtari certifikues punën në bazë të përshkrimit të detyrave apo jo.

Procesi i pagesave duhet të bëhet sipas dispozitave ligjore, që janë në fuqi, ndërsa zyrtarët certifikues duhet ta kenë përkrahjen e duhur për ta kryer aktivitetin e vet. ZAP-i duhet të jetë i saktë në të gjeturat e tij. P.sh, në raportet e auditorit nuk mund të thuhet “*nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur*”. Si mund të matet vëmendja e duhur?

Kosara Nikoliq – Auditori ka konstatuar të meta, por tani duhet të fillojë evitimi i këtyre problemeve dhe të mos lejohet të ketë veprime të reja joligjore. Pra, të mos kemi arsye të flasim vetëm për çështje negative, por për çështje pozitive.

Kryesuesi - Sipas rregullave dhe udhëzimeve administrative, zyrtari certifikues ka rol parandalues në pagesat e paligjshme. Rekomandimet e auditorit janë shumë të rëndësishme. Gjetjet për zyrtarët certifikues nuk janë për t’u nënçmuar. Ministrinë duhet të ndërmarrin masa konkrete për eliminimin e këtyre gjetjeve.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

KMFP-ja e përkrah Raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të auditimit të performancës “Efektiviteti i procesit të certifikimit të pagesave”.

Detyrohen ministrinë, të cilat janë përfshirë në këtë auditim, si: MEF-i, MKRS-ja, MASHT-i, MPB-ja, që lidhur me Raportin, të cilin do ta përgatisin për ZAP-in për veprimet e ndërmarra, ta njoftojë edhe KMFP-n.

5. Të ndryshme

a) Njoftim rreth punës së Komisionit Vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2008 dhe 2009

Riza Smaka - kryesues i Komisionit Vlerësues - I njoftoi anëtarët e Komisioni se vlerësimi i ofertave për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2008 dhe 2009, ka qenë i pamundur për shkak se në mbledhjen e Komisionit Vlerësues ka munguar një anëtarë i Komisionit.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja njëzëri e nxori këtë

VENDIM

Në Komisionin Vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2008 dhe 2009, në vend të deputetit Naser Osmani, caktohet deputetja Anita Morina – Saraçi, ndërsa në vend të deputetit Enis Kervan, caktohet deputeti Haki Shatri.

Anëtarë të Komisionit Vlerësues janë: Riza Smaka, Gani Koci, Anita Morina - Saraçi, Haki Shatri dhe Kosara Nikoliq.

b). Shqyrtimi i raportit të Komisionit Vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2008 dhe 2009

Kryesuesi konstatoi se sipas Raportit të Komisionit Vlerësues, tre nga pesë ofertuesit e kanë përmbushur kriterin “ofertues i përgjegjshëm”. Komisioni Vlerësues e ka rekomanduar kompaninë audituese “GRANT THORTON”, Prishtinë, ta bëjë auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitet 2008 dhe 2009.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, konstatoi se Komisioni Vlerësues, për përzgjedhjen e kompanisë audituese “GRANT THORTON”, Prishtinë, e ka marrë për bazë kriterin: “çmimi më i ulët”.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja njëzëri ka vendosur që Kuvendit t`ia

REKOMANDOJË

Kompaninë audituese “GRANT THORTON”, Prishtinë, që të bëjë auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitet 2008 dhe 2009.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Haki Shatri